



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 19, datë 12.07.2019

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“KAPANON PËR GRUMBULLIM PERIMESH, BASHKIA RROGOZHINË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 12, datë 27.02.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit, në njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)”, me propozim të subjektit “Albania – Piemonte” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kapanon për grumbullim perimesh, Bashkia Rrogozhinë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Albania – Piemonte” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit, do t’i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Rrogozhinë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËRI I LINJËS
MINISTËRI I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Blu
BLEDAR ÇUÇI



Blu
ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

